

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

**Auditim
(zgjidhjet)**

P6

Data 29/06/2024

Detyra 1

Është 1 korrik 2023. Ju jeni një mbikëqyrës auditimi me NetAcc përgjegjës për planifikimin e auditimit përfundimtar të një klienti të ri, Hart Shpk, për vitin që përfundon më 30 shtator 2023. Hart Shpk është e specializuar në projektimin dhe ndërtimin e këndeve të lojërave. Menaxheri i auditimit u takua së fundi me drejtorin financiar të Hart Shpk dhe ju ka ofruar shënimet e mëposhtme:

Shënime nga takimi i planifikimit të auditimit

Hart Shpk ka një fitim të parashikuar para tatimit prej 12.2 milion euro (20X4: 9.3 milion euro) dhe pasuritë totale pritet të jenë 28.5 milion euro (20X4: 24.3 milion euro). Drejtori i financave ka treguar se drejtorët janë shumë të kënaqur me ecurinë e parashikuar për vitin pasi drejtorëve u paguhet një bonus në bazë të përqindjes së fitimit para tatimit.

Hart Shpk po ndërmerr ndërtimin e këndeve të lojërave në 16 lokacione të ndryshme në të gjithë vendin. Të gjitha këndet e lojërave janë ndërtuar sipas specifikave të klientëve. Klientët paguajnë një depozitë prej 25% në nënshkrimin e kontratës dhe saldo e mbetur e pagueshme kur kontrolli i këndit të lojërave i transferohet klientit.

Bilanci i punës në proces (PP) më 30 qershor 2023 është 7.6 milion euro në lidhje me këndet e lojërave në ndërtim. Një numërim dhe vlerësim i PP do të kryhet në të gjitha lokacionet më 30 shtator 2023. Janë marrë masa që ekipi i auditimit të marrë pjesë vetëm në pesë nga numërimet e PP. Hart Shpk u ofron klientëve të saj një garanci pa kosto shtesë, e cila garanton se këndet e lojërave do të funksionojnë siç pritej për një periudhë tre vjeçare. Provizioni i garancisë për vitin aktual është llogaritur si 2% e të ardhurave. Në vitin e kaluar garancia bazohej në 6% të të ardhurave. Drejtori i financës e ka bërë këtë ndryshim pavarësisht se nuk ka dallime të rëndësishme në teknikat e ndërtimit apo nivelin e dëmeve në vit.

Hart Shpk ka bërë shpenzime prej 1.8 milion euro në lidhje me hulumtimin dhe zhvillimin e një lloji të ri të materialit ndërtimor miqësor ndaj mjedisit. 0.6 milion euro nga shpenzimet e deritanishme janë paraqitur si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave. Pjesa e mbetur prej 1.2 milion eurosh është kapitalizuar si një pasuri e patrupëzuar. Asnjë amortizim nuk është njohur deri më sot pasi materiali ende nuk është vënë në përdorim.

Në qershor 2023, kompania kontraktoi blerjen e makinerive të reja me kosto 2.4 milion euro. Ajo pagoi 1 milion euro për nënshkrimin e kontratës për të siguruar makinerinë, të cilat do të dorëzohen në korrik 2023. Për shkak të një problemi me furnizuesin, dorëzimi është vonuar dhe tani është planifikuar të dorëzohen në tetor 2023. Për të financuar kostot e hulumtimit dhe zhvillimit dhe blerjen e makinerive, Hart Shpk bëri një emetim të të drejtave për aksionarët ekzistues me një çmim prej 0.75 euro për çdo aksion prej 0.50 eurosh.

Funksioni i listës së pagave të Hart Shpk i jepet një organizate shërbimi të jashtëm, Caca Shpk, e cila është përgjegjëse për të gjithë elementët e përpunimit të listës së pagave dhe mirëmbajtjen e të dhënave të listës së pagave.

Drejtorët e Hart Shpk shpалosën saktë detajet e tyre të shpërblimit në pasqyrat financiare të parashikuara në përputhje me standardet e SNRF-ve, megjithatë, legjislacioni vendas në vendin në të cilin është bazuar Hart Shpk, kërkon shpалosje më të gjerë. Drejtorët kanë deklaruar se këtë e konsiderojnë të vështirë dhe se nuk kanë ndërmend të japin informacion shtesë.

Kërkohet:

SNA 300 Planifikimi i një Auditimi të Pasqyrave Financiare ofron udhëzime për të ndihmuar auditorët në planifikimin e një auditimi.

(a) Shpjegoni përfitimet e planifikimit të auditimit. **(4 pikë)**

(b) Përshkruani TETË rreziqe auditimi dhe shpjegoni përgjigjen e auditorit ndaj secilit rrezik në planifikimin e auditimit të Hart Shpk (në formatin e tabelës). **(16 pikë)**

Rreziku i auditimit	Përgjigja e auditorit

(c) Përshkruani procedurat thelbësore që auditori duhet të kryejë për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi në lidhje me shpërblimet e drejtorit të Hart Shpk

(5 pikë)

Në fund të takimit të planifikimit, drejtori i financave të Hart Shpk përmendi menaxherin e auditimit se një nga arsyet kryesore që NetAcc u emërua si auditor ishte për shkak të njohurive të saj për industrinë. Megjithatë, kishte disa shqetësime, se si NetAcc do t'i mbante konfidenciale informacionet e marra gjatë auditimit pasi auditon tre kompani të tjera ndërtimi të specializuara në materiale ndërtimi miqësore me mjedisin, duke përfshirë konkurrentin kryesor të Hart Shpk.

(d) Shpjegoni masat mbrojtëse që NetAcc duhet të zbatojë për të siguruar që ky konflikt interesi të menaxhohet siç duhet. **(5 pikë)**

Gjithsej: (30 pikë)

Zgjidhja

(a) Planifikimi i auditimit trajtohet nga SNA 300 Planifikimi i një Auditimi të Pasqyrave Financiare. Ai thekson se auditimi përfiton nga planifikimi adekuat në disa mënyra:

- Ndhurma e auditorit që t'i kushtojë vëmendjen e duhur fushave të rëndësishme të auditimit.
- Ndhurma e auditorit për të identifikuar dhe zgjidhur problemet e mundshme në kohën e duhur.
- Ndhurma e auditorit për të organizuar dhe menaxhuar siç duhet angazhimin e auditimit në mënyrë që ai të kryhet në mënyrë efektive dhe efikase.
- Ndhurma në përzgjedhjen e anëtarëve të ekipit të angazhimit me nivele të përshtatshme të aftësive dhe kompetencës për t'iu përgjigjur rreziqeve të parashikuara dhe caktimin e duhur të punës për ta.
- Lehtësimi i drejtimit dhe mbikëqyrjes së anëtarëve të ekipit të angazhimit dhe rishikimi i punës së tyre.
- Asistimi, sipas rastit, në koordinimin e punës së kryer nga ekspertët.

(b) Rreziqet dhe përgjigjet

Rreziku i auditimit	Përgjigja e auditorit
Hart Shpk është një klient i ri për NetAcc. Duke qenë se ekipi i auditimit nuk është i njohur me politikat kontabël, transaksionet dhe bilancet e Hart Shpk, do të ketë një rrezik të rritur zbulimi për auditimin. Ka gjithashtu më pak siguri për bilancet e hapjes pasi NetAcc nuk e kreu auditimin vitin e kaluar.	NetAcc duhet të sigurojë se ka një ekip me përvojë të përshtatshme të caktuar për auditim dhe se u lejohet kohë e mjaftueshme anëtarëve të ekipit për të kuptuar kompaninë dhe rreziqet e anomalisë materiale, duke përfshirë një informim të detajuar të ekipit për të mbuluar fushat kryesore të rrezikut. Duhet të kryhen procedura shtesë auditimi mbi bilancet e hapjes.
Drejtoreve u paguhet një bonus bazuar në një përqindje të fitimit para tatimit për vitin. Ekziston rreziku që drejtorët të përpiqen të mbivlerësojnë fitimin, dhe për rrjedhojë shpërblimet e tyre duke rritur të ardhurat dhe duke ulur shpenzimet. Ky është një rrezik i veçanërisht në lidhje me fushat gjykuese si provizionet dhe vlerësimet.	Ekipi i auditimit duhet të jetë i vetëdijshëm për rreziqet në rritje të manipulimit dhe duhet të caktojë anëtarë më me përvojë të auditimit për vlerësime të rëndësishme dhe fusha gjykimi. Gjithashtu, duhet t'u jepet kohë e mjaftueshme anëtarëve të ekipit për të kuptuar kompaninë dhe rreziqet e rëndësishme të mbivlerësimit të fitimit, duke përfshirë pjesëmarrjen në një takim të ekipit të auditimit. Ekipi duhet të ruajë skepticizmin profesional dhe të jetë vigjilent ndaj rrezikut të shtuar të manipulimit. Duhet të korrigjimin e shënimeve në ditar.
Konsumatorët paguajnë një depozitë prej 25% me nënshkrimin e kontratës për blerjen e këndeve të lojërave. Depozitat nuk duhet të njihen si të hyra menjëherë dhe në vend të kësaj duhet të njihen si të hyra të shtyra (detyrime kontraktuale) brenda detyrimeve afatshkurta derisa detyrimet e performancës, sipas kontratave, të jenë përmbushur. Kjo ka gjasë	Ekipi i auditimit duhet të marrë një kopje të kontratave me klientët dhe t'i rishikojë ato për të kuptuar detyrimet e performancës. Ata duhet të diskutojnë me menaxhmentin kriteret për të përcaktuar nëse detyrimet e performancës janë përmbushur dhe trajtimin e depozitave të marra për të siguruar që ai është i përshtatshëm dhe në përputhje me standardet përkatëse.

<p>të jetë në një moment në kohë, kur kontrolli i këndit të lojërave i kalohet klientit. Ekziston rreziku që të hyrat të mbivlerësohen dhe detyrimet afatshkurta të nënvlerësohen nëse depozitat janë regjistruar si të hyra.</p>	<p>Gjatë auditimit përfundimtar, ekipi i auditimit duhet të ndërmarrë testime të shtuara mbi prerjen e të hyrave dhe plotësinë e të hyrave të shtyra (detyrimet e kontratës).</p>
<p>Ekipi i auditimit do të marrë pjesë vetëm në numërimin e PP në pesë nga 16 vendet. PP është një saldo materiale dhe vlerësimi i PP është një fushë gjykuese. Meqenëse ekipi i auditimit nuk po ndjek të gjitha vendet, rreziku i mos-zbulimit rritet pasi ekipi nuk do të jetë në gjendje të marrë drejtpërdrejt dëshmi në lidhje me PP.</p>	<p>Auditori duhet të vlerësojë se cilat numërime të stoqeve do të marrë pjesë ekipi, me shumë gjasa që të jenë ato me saldote më materiale të PP ose që vlerësohen se kanë rrezikun më të madh të anomalisë. Për ato numërime të stoqeve që nuk morën pjesë, ekipi i auditimit do të duhet të marrë dhe rishikojë dokumentacionin në lidhje me kontrollet rreth numërimit dhe do të duhet të rishikojë raportet nga çdo ekspert i përdorur për të vlerësuar PP, dhe çdo përjashtim të vërejtur gjatë numërimit dhe të diskutojë me menaxhmentin çdo çështje që lind gjatë numërimit.</p>
<p>Hart Shpk u ofron klientëve të saj një garanci pa kosto shtesë, e cila garanton se këndet e lojërave do të funksionojnë siç pritej për tre vjet. Provizionet llogaritet si 2% e të hyrave në vitin aktual kundrejt 6% të vitit të kaluar, pavarësisht se nuk ka ndryshime në teknikat e ndërtimit apo në nivelin e dëmeve. Sipas SNK 37 Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë Kontingjente kjo duhet të njihet si një provizion garancie. Llogaritja e provizioneve të garancisë kërkon gjykim pasi është një shumë e pasigurt. Ekziston rreziku që provizioni i garancisë mund të nënvlerësohet, duke çuar në shpenzime dhe detyrime të nënvlerësuara.</p>	<p>Ekipi i auditimit duhet të diskutojë me menaxhmentin bazën e llogaritjes së provizioneve dhe ta krahasojë këtë me mesataret e industrisë dhe nivelin e pretendimeve pas fundit të vitit, nëse ka, të bëra nga klientët. Në veçanti, ata duhet të diskutojnë arsyetimin pas uljes së nivelit të ofrimit këtë vit. Ekipi i auditimit duhet gjithashtu të krahasojë provizionin e vitit të kaluar me nivelin aktual të pretendimeve në vit, për të vlerësuar arsyeshmërinë e gjykimeve të bëra nga menaxhmenti.</p>
<p>Hart Shpk ka njohur 0.6 milion euro shpenzime të hulumtimit në pasqyrën e të ardhurave, ku pjesa e mbetur prej 1.2 milion euro është kapitalizuar si shpenzim zhvillimi. SNK 38 Pasuritë e patrupëzuara ka kriteret strikte se cilat kosto mund të kapitalizohen si shpenzime zhvillimi. Ekziston rreziku që kërkesat e standardit të mos jenë zbatuar si duhet. Nëse kostot e hulumtimit janë klasifikuar gabimisht si shpenzime zhvillimi, ekziston rreziku që pasuritë e patrupëzuara të mbivlerësohen dhe shpenzimet e hulumtimit të nënvlerësohen.</p>	<p>Ekipi i auditimit duhet të marrë një përmbledhje të shpenzimeve të hulumtimit të njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe të kostove të zhvillimit të kapitalizuara dhe të rishikojë dokumentacionin mbështetës për të përcaktuar nëse ato janë klasifikuar saktë. Çdo shpenzim zhvillimi duhet të miratohet më pas duke përmbushur kriteret përkatëse për kapitalizimin siç përcaktohet në SNK 38. Ekipi duhet gjithashtu të diskutojë trajtimin kontabël me drejtorin financiar dhe të sigurojë që ai është në përputhje me SNK 38.</p>
<p>Hart Shpk bëri një porosi për 2.4 milion euro makineri, duke paguar 1 milion euro paraprakisht. Makineria duhej të merrej në</p>	<p>Rishikoni regjistrin e pasurive joqarkulluese për të përcaktuar nëse 1 milion euro të paguara paraprakisht është kapitalizuar.</p>

<p>korrik 2023 por tani do të dorëzohet pas fundit të vitit.</p> <p>Vetëm pasuritë që ekzistojnë fizikisht në fund të vitit duhet të kapitalizohen si prona, impiantet dhe pajisjet (PPE). Depozita prej 1 milion eurosh e paguar paraprakisht duhet të njihet si parapagim.</p> <p>Nëse depozita prej 1 milion eurosh e paguar paraprakisht është kapitalizuar brenda PPE, atëherë pagesat paraprake nënvlerësohen dhe PPE do të mbivlerësohen.</p>	<p>Diskutoni trajtimin e duhur kontabël me menaxhmentin për të konfirmuar që shuma e paguar paraprakisht njihet si parapagim dhe nëse njihet gabimisht, rishikoni shënimin korigjues të ditarit.</p>
<p>Hart Shpk bëri një emetim të të drejtave në vit. Ky është një transaksion jo standard dhe ekziston rreziku i shtuar që çështja të mos jetë regjistruar saktë.</p> <p>Emetimi i të drejtave është bërë me një prim dhe për këtë arsye kërkon të ndahet në kapitalin e tij aksionar dhe në elementet e primit të aksioneve.</p> <p>Ekziston rreziku që ndarja midis kapitalit aksionar dhe primit të aksioneve të mos jetë llogaritur saktë dhe që këto bilanc të jenë të gabuara. Ekziston gjithashtu një rrezik që çështja e të drejtave të mos shpaloset në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe legjislacionin vendas të kompanive.</p>	<p>Ekipi i auditimit duhet të marrë dokumentacionin ligjor në mbështetje të emetimit të të drejtave për të rënë dakord për numrin e aksioneve të emetuara dhe çmimin e të drejtave. Ata duhet të rillogaritin ndarjen e kapitalit aksionar dhe primin e aksioneve dhe ta pranojnë këtë me hyrjen në ditar për të regjistruar emetimin e të drejtave.</p> <p>Ekipi i auditimit duhet gjithashtu të pajtohet që shpalosjet janë adekuate dhe në përputhje me standardet dhe legjislacionin.</p>
<p>Funksioni i listës së pagave të Hart Shpk i jepet një organizate shërbimi të jashtëm. Një rrezik moszbulimi lind nëse ka dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në Hart Shpk për të konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e kontrolleve mbi ciklin e listës së pagave dhe detyrimet në fund të vitit.</p> <p>Duhet t'i kushtohet vëmendje nivelit të kontrolleve të vendosura në organizatën e shërbimit dhe nëse të dhënat janë të besueshme. Nëse ndodh ndonjë gabim, këto mund të rezultojnë në shpenzimet e pagave dhe mëditjeve dhe çdo akruale të keqdeklaruar.</p>	<p>Diskutoni me menaxhmentin çdo ndryshim në masën e të dhënave të mbajtura në Hart Shpk që nga auditimi i vitit të kaluar dhe çdo monitorim të kontrolleve që është ndërmarrë nga menaxhmenti mbi listën e pagave.</p> <p>Duhet t'i kushtohet vëmendje kontaktit me auditorin e organizatës së shërbimit, për të konfirmuar nivelin e kontrolleve të vendosura. Mund të kërkohet një raport i tipit 1 ose i tipit 2.</p> <p>Merrni parasysh shkallën në të cilën mund të merren evidenca të mjaftueshme të përshtatshme auditimi nga të dhënat e mbajtura në Hart Shpk në lidhje me shpenzimet dhe detyrimet për pagat dhe mëditjet.</p>
<p>Shpalosja e informacioneve shpjeguese për shpërblimin e drejtorëve është bërë në përputhje me Standardet IFRS®, por jo me legjislacionin vendas.</p> <p>Aty ku legjislacioni vendas është më gjithëpërfshirës se standardet SNRF, ka të ngjarë që kompania të jetë në përputhje me legjislacionin vendas.</p> <p>Shpalosja e shpërblimit të drejtorëve nuk do të jetë e plotë nëse informacioni shtesë nuk shpaloset.</p>	<p>Diskutoni këtë çështje me menaxhmentin dhe rishikoni kërkesat e legjislacionit vendor për të përcaktuar nëse shpalosja në pasqyrat financiare është përfshirë siç duhet.</p>

(c) Procedurat thelbësore për shpërblimet e drejtorëve

- Merrni një listë të bonusit të drejtorëve dhe kreyini veprimet matematikore për të siguruar saktësinë e tij. Dakordoni shumë me atë të shpalosur në pasqyrat financiare.
- Rishikoni lshitën e detyrimeve afatshkurta dhe konfirmoni që akumulimi i bonusit është përfshirë si detyrim në fund të vitit.
- Dakordoni pagesat individuale të bonusit në të dhënat e listës së pagave pas fundit të vitit.
- Rillogaritni pagesat e bonusit dhe dakordoni me kriteret në dokumentacionin mbështetës dhe përqindjet që duhet të paguhen në kontratat e shërbimit të drejtorëve.
- Konfirmoni shumë e çdo bonusi të paguar duke dakorduar me librin e parave të gatshme pas fundit të vitit dhe pasqyrat bankare.
- Krahasoni fitimin para tatimit të përdorur në llogaritjen e bonusit me fitimin përfundimtar para tatimit për të konfirmuar nëse kërkohet ndonjë rregullim në bonusin e paguar dhe diskutoni ndonjë ndryshim me menaxhmentin.
- Dakordoni shumat që i paguhen secilit drejtor me procesverbalet dhe kontratat e bordit për të siguruar që shumat e përfshira në pasqyrat financiare të vitit aktual janë grumbulluar dhe shpalosur plotësisht.
- Rishikoni procesverbalet e bordit për të identifikuar nëse ndonjë pagesë shtesë në lidhje me këtë vit është rënë dakord për ndonjë drejtor.
- Merrni një përfaqësim me shkrim nga menaxhmenti që konfirmon plotësinë e shpërblimit të drejtorëve duke përfshirë bonusin.
- Rishikoni shpalosjet e bëra në lidhje me bonusin e paguar drejtorëve dhe vlerësoni nëse ato janë në përputhje me legjislacionin vendas.

(d) Masat mbrojtëse

- Si Hart Shpk ashtu edhe konkurrenti i saj duhet të njoftohen se NetAcc do të veprojnë si auditorë për secilën kompani dhe duhet të merret pëlqimi nga menaxhmenti i secilës kompani.
- NetAcc duhet të konsiderojë këshillimin e njërit ose të dy klientëve për të kërkuar këshilla shtesë të pavarura.
- NetAcc duhet të sigurojë se do të caktojë ekipe të veçanta angazhimi, me partnerë të ndryshëm angazhimi dhe anëtarë të ekipit për secilin klient; pasi një punonjës të ketë punuar në një auditim, siç është Hart Shpk, atëherë ai duhet të pengohet të jetë në auditimin e konkurrentit për një periudhë kohore.
- Procedurat adekuate duhet të vendosen brenda firmës për të parandaluar qasjen në informacion, për shembull, ndarje të rreptë fizike të të dy ekipeve, regjistrim konfidencial dhe të sigurt të të dhënave.
- NetAcc duhet të përcaktojë udhëzime të qarta për anëtarët e secilit ekip angazhimi për çështjet e sigurisë dhe konfidencialitetit. Këto udhëzime mund të përfshihen në letrat e angazhimit të auditimit që i dërgohen secilit klient.
- NetAcc duhet të marrë parasysh përdorimin e marrëveshjeve të konfidencialitetit të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e ekipeve të angazhimit të Hart Shpk dhe konkurrenti.
- Puna e kryer duhet të rishikohet nga një rishikues i duhur i cili nuk është i përfshirë në auditim për të vlerësuar nëse gjykimet dhe konkluzionet kryesore janë të përshtatshme.
- Monitorimi i rregullt i zbatimit të masave mbrojtëse të mësipërme duhet të ndërmerret nga një individ i lartë në NetAcc që nuk është i përfshirë në asnjërin nga auditimet.

Detyra 2

Është 1 korrik 2023. Sita Shpk printon libra që i shet në internet dhe ua furnizon shitësve me pakicë në të gjithë vendin. Fundi i vitit të kompanisë është 30 shtator 2023. Ju jeni një mbikëqyrës auditimi me Tarifa Co, duke përgatitur draft programet e auditimit dhe duke rishikuar dokumentacionin e kontroleve të brendshme në përgatitje për auditimin e ndërmjetëm.

Lista e pagave

Sita Shpk punëson staf të fabrikës, të cilëve u kërkohet të punojnë një turn standard prej tetë orësh në ditë. Asnjë pjesëtar i stafit nuk kërkohet të punojë jashtë orarit. Të gjithë anëtarët e stafit paguhen çdo muaj me transfertë bankare. Kompania ka një departament të burimeve njerëzore (BNJ) i cili është përgjegjës për regjistrimin dhe vendosjen e të gjithë punonjësve të rinj dhe një departament të listës së pagave që përpunon pagat dhe mëditjet.

Kur një punonjës i ri bashkohet me kompaninë, BNJ plotëson një formular të punonjësve të ri i cili përfshin një numër unik punonjësi për çdo punonjës të ri. Formulari dërgohet më pas në departamentin e listës së pagave në mënyrë që punonjësi i ri të mund të vendoset për pagesë. Numri unik i punonjësit duhet të futet në sistemin e listës së pagave përpara se punonjësi të mund të shtohet në listën e pagave. Në baza mujore, një raport përjashtimi në lidhje me ndryshimet në të dhënat e gjendjes së pagave prodhohet dhe rishikohet nga menaxheri i listës së pagave i cili evidenton këtë rishikim.

Orët e punës së punonjësve dhe normat e pagave të tyre për orë janë të paracaktuara në sistem, i cili automatikisht llogarit pagën bruto dhe neto së bashku me zbritjet përkatëse dhe gjeneron fletëpagesat e punonjësve. Mbikëqyrësi i listës së pagave zgjedh një mostër të fletëpagesave, rikryen llogaritjet e pagave bruto në neto dhe heton çdo mospërputhje. Mostra e fletëpagesave më pas nënshkruhet si dëshmi e këtij rishikimi.

Blerjet

Kompania ka një departament blerjesh me seli në zyrën e saj qendrore. Kur kërkohen lëndë të para, mbikëqyrësit e prodhimit dorëzojnë një formular kërkesë në departamentin e blerjeve. Gjenerohet një urdhër blerjeje me disa kopje dhe menaxheri i blerjeve autorizon të gjitha porositë deri në 5,000 euro. Porositë mbi 5,000 euro autorizohen nga drejtori i blerjes.

Ekipi i depos përpunon mallrat e marra nga furnitorët. Ata pranojnë mallrat e marra me porosinë e blerjes dhe kontrollojnë sasinë dhe cilësinë e mallit. Pas përfundimit të këtyre kontroleve prodhohet një fletëpranim (FP). Një kopje e FP-së më pas nënshkruhet dhe depozitohet në depo. Një kopje tjetër e FP i dërgohet departamentit të financave

Një nëpunës i librit të të pagueshmeve regjistron faturat e blerjes në grupe prej 20 faturash në librin e ditor të blerjes duke përdorur totalet e kontrollit. Një fletë kontrolli plotësohet për çdo grup prej 20 faturash dhe nëpunësi nënshkruan për të evidentuar kontrollin e kryera.

Barazimet e kartelave të furnitorit kryhen në baza mujore. Të gjitha ndryshimet hetohen plotësisht dhe kontrolluesi financiar i rishikon këto rakordime. Faturat paguhen në përputhje me kushtet e kreditimit të furnizuesit. Drejtori i financave autorizon listën e pagesave të transfertave bankare për furnitorët pasi së pari kanë rënë dakord për shumat që duhet të paguhen në dokumentacionin mbështetës dhe kanë shqyrtuar listën për pagesa të dyfishta.

Kërkohe:

Auditorëve u kërkohet të dokumentojnë sistemet e kontabilitetit dhe të kontrollit të brendshëm të një kompanie si pjesë e procesit të tyre të auditimit. Tre metoda të disponueshme për dokumentimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm janë shënimet narrative, diagramet dhe pyetësorët.

- (a) Për secilën nga TRE metodat e identifikuara:
- (i) Përshkruani metodën për dokumentimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm; dhe
 - (ii) Shpjegoni dhe Avantazhin e përdorimit të kësaj metode.

(përdorni formën tabelare për t'u përgjigjur)

(6 pikë)

	Përshkrim	Avantazhi
Shënime narrative		
Diagramët		
Pyetësorët		

- (b) Në lidhje me sistemin e kontrollit të brendshëm të Sita Shpk:
- (i) Identifikoni dhe shpjegoni SHTATË KONTROLLET KYÇE mbi të cilat auditori mund të kërkojë të mbështetet; dhe
 - (ii) Përshkruani një TEST të KONTROLLIT që auditori duhet të kryejë për të vlerësuar nëse secili prej këtyre kontrolleve kryesore funksionon në mënyrë efektive.

(14 pikë)

Kontrolli kyç	Testi i kontrollit

Gjithsej: 20 pikë

Zgjidhja

Sita Shpk

(a) Dokumentimi i sistemeve

	Përshkrim	Avantazhi
Shënime narrative	Shënimet narrative përbëhen nga një përshkrim me shkrim i sistemit. Ato detajojnë se çfarë ndodh në sistem në çdo fazë dhe përfshijnë detaje të çdo kontrolli që funksionon në çdo fazë.	Ato janë të thjeshta për t'u regjistruar; pas diskutimit me anëtarët e stafit, këto diskutime shkruhen lehtësisht si shënime. Ato mund të lehtësojnë mirëkuptimin nga të gjithë anëtarët e ekipit të auditimit, veçanërisht anëtarët më të rinj të cilët mund t'i shohin metodat alternative shumë komplekse.
Diagramët	Diagramët janë një ilustrim diagrami i sistemit të kontrollit të brendshëm. Linjat zakonisht demonstrojnë sekuencën e ngjarjeve dhe simbolet standarde përdoren për të nënkuptuar kontrollet ose dokumentet.	Me diagram është e lehtë të shihet sistemi në tërësinë e tij, pasi ai është paraqitur i gjithë së bashku në një diagram. Për shkak të përdorimit të simboleve standarde për kontrollet, ai mund të jetë efektiv në identifikimin e kontrolleve që mungojnë.
Pyetësorët	Pyetësorët e kontrollit të brendshëm (PKB) ose pyetësorët e vlerësimit të kontrollit të brendshëm (PVKB) përmbajnë një listë pyetjesh për çdo cikël të madh transaksioni; PKB-të përdoren për të vlerësuar nëse ekzistojnë kontrollet, ndërsa PVKB-të vlerësojnë efektivitetin e kontrolleve të vendosura.	Pyetësorët përgatiten shpejt, që do të thotë se janë një metodë në kohë për regjistrimin e sistemit. Nëse hartohen tërësisht, ato sigurojnë që të gjitha kontrollet e pranishme brenda sistemit të merren parasysh dhe të regjistrohen, prandaj kontrollet që mungojnë ose dobësitë theksohen qartë nga ekipi i auditimit.

(b) Kontrollat kryesore dhe testet e kontrollit

Kontrolli kyç	Testi i kontrollit
Sita Shpk ka një departament të veçantë të burimeve njerëzore (BNJ), i cili është përgjegjës për vendosjen e të gjithë punonjësve të rinj. Ndarja e roleve midis departamenteve të BNJ dhe listës së pagave zvogëlon rrezikun e	Rishikoni përshkrimet e punës së listës së pagave dhe burimeve njerëzore për të konfirmuar ndarjen e përgjegjësive në lidhje me vendosjen e punonjësve të rinj. Diskutoni me anëtarët e departamentit të listës së pagave procesin për vendosjen e

<p>krijimit të punonjësve fiktiv dhe gjithashtu të pagesës së tyre.</p>	<p>punonjësve të rinj dhe dakordoni punonjësit e rinj me dokumentacionin e iniciuar nga BNJ.</p>
<p>Të gjithë punonjësve të rinj u caktohet një numër unik punonjësi nga BNJ. Sistemi i listës së pagave nuk është në gjendje të përpunojë punonjësit e rinj pa përfshirjen e numrit unik të punonjësve. Duke qenë se stafi i listës së pagave nuk është në gjendje të vendos punonjës të rinj pa numrin e punonjësve nga formulari, kjo zvogëlon rrezikun e krijimit të punonjësve fiktive nga lista e pagave.</p>	<p>Përpjekja për të shtuar një punonjës të ri në sistemin e listës së pagave pa një numër unik punonjësi, sistemi duhet ta refuzojë këtë shtesë.</p>
<p>Në baza mujore një raport përjashtimi i ndryshimeve në të dhënat e gjendjes së pagave prodhohet dhe rishikohet nga menaxheri i listës së pagave. Kjo siguron që çdo ndryshim i paautorizuar në të dhënat e përhershme të identifikohet dhe hetohet në kohën e duhur, në mënyrë që të dhënat e përdorura gjatë ekzekutimit të listës së pagave të jenë të vlefshme dhe të sakta.</p>	<p>Zgjidhni një mostër të raporteve mujore të përjashtimeve dhe rishikoni për dëshmi të rishikimit dhe ndjekjen e çdo ndryshimi të papritur nga menaxheri i listës së pagave.</p>
<p>Mbikëqyrësi i listës së pagave zgjedh një mostër të fletëpagesave dhe rillogarit llogaritjet e pagave bruto në neto, krahason rezultatet me rezultatet nga sistemi i listës së pagave dhe heton çdo mospërputhje. Kjo zvogëlon rrezikun që sistemi i automatizuar të gjenerojë gabime gjatë përpunimit të listës së pagave. Çdo gabim do të identifikohet në kohën e duhur për të parandaluar që pagat të jenë mbi ose nën pagesë.</p>	<p>Rishikoni fletëpagesat mujore të mostruara nga mbikëqyrësi i listës së pagave për nënshkrimin e tyre për dëshmi se është ndërmarrë rishikimi i llogaritjeve. Për një mostër të listës së pagave mujore, rikryeni llogaritjen e pagës bruto në neto dhe krahasoni me sistemin e listës së pagave, diskutoni çdo mospërputhje me mbikëqyrësin e listës së pagave.</p>
<p>Urdhrat e blerjeve deri në 5,000 euro autorizohen nga menaxheri i blerjeve dhe mbi 5,000 euro nga drejtori i blerjeve. Kjo siguron që të blihen vetëm mallrat që kërkohen nga Sita Shpk dhe lidhen me shpenzimet e vërteta të biznesit.</p>	<p>Zgjidhni një mostër të porosive të blerjes dhe rishikoni për dëshmi të autorizimit në përputhje me kufijtë e autorizimit. Përputhni këtë me nënshkrimin e duhur në listën e nënshkruesve të miratuar.</p>
<p>Departamenti i depos dakordon fletëpranimet e mallrave nga furnitorët me një kopje të urdhrat të blerjes dhe konfirmon sasinë dhe cilësinë e mallrave të marra dhe nënshkruan FP për të evidentuar kontrollet. Kjo siguron që Sita Shpk nuk po regjistron detyrimet dhe më pas nuk po paguan për marrjen e mallrave me cilësi të ulët ose për mallrat që nuk i ka porositur.</p>	<p>Gjatë auditimit të ndërmjetëm vëzhgoni departamentin e depos kur pranoni mallrat për të kuptuar nivelin e kontroleve që po ndërmerren. Rishikoni një mostër të FP të mbajtura në departamentin e depos për nënshkrim, si dëshmi e kontroleve që po ndërmerren në marrjen e mallrave.</p>
<p>Faturat e blerjeve regjistrohen në librin ditor të blerjes në grupe, duke përdorur totalet e kontrollit. Përdorimi i totaleve të kontrollit siguron si plotësinë ashtu edhe saktësinë mbi futjen e</p>	<p>Zgjidhni një mostër të fletëve totale të kontrollit dhe rishikoni për evidencën e totalit të kontrollit të përdorur dhe nënshkrimin e nëpunësit.</p>

<p>faturave të blerjes. Nëse faturat nuk janë të gjitha të dhëna të plota dhe të sakta, të pagueshmet mund të jenë të gabuara.</p>	
<p>Barazimet e kartelave të furnitorëve ndërmerren në baza mujore dhe këto rishikohen nga kontrolluesi financiar. Kjo siguron që çdo gabim në regjistrimin e blerjeve dhe të pagueshmeve të identifikohet dhe korrigjohet në kohën e duhur dhe për këtë arsye që të pagueshmet të jenë të plota dhe të sakta.</p>	<p>Rishikoni dosjen e barazimeve për t'u siguruar që ato janë duke u kryer në baza të rregullta dhe se janë rishikuar nga një zyrtar përgjegjës. Rikryeni barazimin për një mostër për t'u siguruar që ato janë kryer në mënyrë të duhur dhe mospërputhjet janë hetuar.</p>
